



Republika e Kosovës

Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës Istog

Skupština Opštine Istok
Municipal Assembly Istog

Komitetit për Politikë dhe Financa/Komitet za Politiku i Financije/ Policy and Finance Committee

7	Procesverbal
Tipi i mbledhjes:	Mbledhje e rregullt e KPF-së
Data e mbajtjes:	19.09.2018, në ora 13:00
Mbledhjen e kryesoi:	Qaush Balaj, Kryesues i Kuvendit
Procesmbajtës:	Vjosa Hysenaj, Zyrtare për punë të Kuvendit të Komunës
Pjesëmarrës anëtarët e KPF-së	Haki Podrimaj, Zenel Shatri, Eliot Kukiqi, Ardita Idrizaj, Ajshe Metaj.
Mungojnë:	Besa Ferati,
Pjesëmarrës të tjerë:	Nënkryetari Lulzim Blakaj, Hazbi Bajra, Hysni Maxharraj, Isa Hoxha, Hazbi Bajra, Fitim Nuhiu dhe Hysena Pelaj OSBE, Lulzim Shoshi, Enver Rugova, Jeta Balaj,
Rendi i ditës:	
1. Shqyrtimi dhe miratimi i Draft Buxhetit për vitin 2019-2021.	
Diskutimet:	
Kryesuesi – z. Qaush Balaj - përshëndet Nënkryetarin z. Lulzim Blakaj, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, Drejtorët, Zyrtar të Administratës Komunale, përfaqësues të OSBE, KFORI, mirë se keni ardhur ju faleminderit për pjesëmarrje. Duke pasur parasysh se kuorumi për mbajtjen e mbledhjes së Komitetit për Politikë e Financa është arritur me lejoni që të shpallë të hapura punimet e mbledhjes së Komitetit për Politikë e Financa. Pyet nëse ka dikush ndonjë pyetje. Vazhdohet me mbledhjen kryesuesi lexon propozimet e qytetareve nga Dëgjimi publik i cili u mbajt me datë 19.09.2018 në ora 11:00. Propozimet: Sejdi H Kabashi – në fshatin Gjurakoc kubëzimi i trotuarit prej Jazit të Goges e deri të ura e Istogut, Zenel Shatri – Ndërtimi i kanalizimit në fshatin Tomic lagja Bregu. Argjend Kadaj – Të bëhet pastrimi i deponis në Pollaqer në fshatin Lubozhd, Ti i ndërtohet shtëpia z. Miftar Osë Alilaj në Lubozhd Dhe ku ka qenë përpara kulla e popit tani të bëhet një pllakë me emrat që i kanë mbytur në atë kullë.	

Haki Tafilaj – Rakosh të bëhet infrastruktura rrugore,
Të sillen kontinjeret për mbeturina
dhe Ujësjells.

Smajl Camaj – Saradran, Ndërtimi i kanalizimit në lagjen Camaj, Sylaj dhe Kasumaj,
Asfaltimi i rrugesë Saradran – Luga- Ruhot.
Dhe asfaltimi i rrugës Llugat e Poshtme – Llugat e epërme me gjatësi prej 500 m.

Cenc Demaj – Saradran, asfaltimi i rrugës “Tahir Demaj” me gjatësi prej 300 m.

Ali Jahaj, Rakosh – Sjellja e ujit të prijëse,
Kontejnerët për mbeturina,
Infrastruktura rrugore.

Riza Alihajdaraj – Vazhdimi i ndërtimit të rrugës Çameria në Istog të Poshtë 200 m.

Homdi Sadikaj – Studenic, Të ndërtohet rruga që lidh bjeshkët e Studenicet “Bregu i Kishës”.

Ramadan Zeqiraj – Studenic , Ndërtimi i rrugës malore Shoshan – Lugu i mahalles dhe
Ndërtimi i kanalizimit në lagjen Gorqaj, Maxharraj dhe Zeqiraj që ujr
e zeza të hiqen nga përroi i fshatit.

Abedin Neziraj – Istog – Asfaltimi i rrugës “Arben Januzaj” dhe
Asfaltimi i rrugës “Shkoza”

Nazmi Mxharraj – Studenic , Ndërtimi i trotuarit nga Vrella në Studenicë.

Haxhi Gashi Studenic – Ndërtimi i rrugëve të Bjeshkës “Bregu i Kishesë”
Ndërtimi i kanalit të ujitjes Vrellë – Prigodë,

Regjë Mulaj – Gurrakocë , Rregullimi i kulmit të Qendrës mesimore në Gurrakoc,
Rregullimi i qendrës muzikore në departamentin e rinisë në QM,
Furnizimi i hapsirave të QM-së me lëndë djegse gjatë dimrit,
Ofrimi i kontenjerve në rrugën “7marsi” Gurrakoc,
Rregullimi i pushimoreve në parkun në Gurrakoc.

Ahmet Haxhiaj – Rakosh, Asfaltimi i Rrugës në lagjen Haxhiaj 250 m.

Ramë Hajraj – Dushkaja – Funkcionalizimi dhe mbështetja financiar e KVRL-së,
Funkcionalizimi i Qendrës Rinore.

* Anëtarët e Komitetit për politikë e Financa, diskutuan propozimet nga Dëgjimi publik dhe u vendos që të gjitha këto propozime të përfshihen në draft buxhetin 2019-2021.

Konstatohet se miratohet një zërit, pa vërejtje me propozimet e dëgjimit publik.	
Vendimet:	
Miratohetën propozimet e dëgjimit publik nga KPF-së pa vërejtje	
Personat përgjegjës për zbatim:	
Afati për zbatim:	Deri në mbledhjen e kuvendit
DISKUTIME	
Kryesuesi – para mbylljes së mbledhjes konstaton kuorumin prezentë ishin një anëtar mungonte nga Komitetit për Politik e Financa, ju faleminderit për pjesëmarrje dhe kontributin e dhënë për këtë mbledhje. Shpall të mbyllura punimet për këtë mbledhje.	
Mbledhja përfundoj :	14:10